

VENDIM
Nr. 102, datë 9.4.2026

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “RENRGY TRADING GROUP”
SHPK PËR KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË
GARANCIVE TË ORIGJINËS**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të nenit 6, të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 9.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 774/2 prot., datë 8.4.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘ReNRGY Trading Group’ sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës”, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k,
 - Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 163, datë 19.7.2018, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19/2023, si dhe është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190/2023.
 2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria
 - Në mbështetje të nenit 5 të rregullores, ku përcaktohet se çdo person fizik ose juridik apo subjekt ka të drejtën të aplikojë për t’u regjistruar në regjistrin e garancive të origjinës të ERE-s, shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k. me anë të *email-it*, protokolluar me nr. 774 prot., datë 2.3.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës. Sipas kërkesave të nenit 6, pika 4.1, të rregullores, shoqëria ka përcjellë të plotësuar, duke specifikuar të dhënat identifikuese.
 3. Analiza ligjore dhe vlerësimi
 - Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
 - Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për hapjen e llogarisë në regjistër si furnizues/tregtar i energjisë elektrike.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k, për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, për tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike.
 2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës të njoftojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., lidhur me vendimin e Bordit të ERE.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që

mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti